



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" DURRËS  
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 130/3 prot.

Durrës, më 23/01/2020

**VENDIM**  
Nr. 6, datë 23.01.2020

**PËR**  
**"PËR MIRATIMIN E LISTËS EMËRORE TË STUDENTËVE TË CIKLIT TË PARË ME**  
**KOHË TË PLOTË, QË PËRJASHTOHEN NË MASËN 100% NGA TARIFA E**  
**SHKOLLIMIT, PËR VITIN AKADEMIK 2019 – 2020"**

Në mbështetje të nenit 4 "e drejta e studimit", nenit 49 "Funksionet e bordit të Administrimit", nenit 98 "të drejtat dhe detyrimet e studentëve" të ligjit nr. 80/2015, "Për Arsimin e Lartë dhe kërkimin shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", të nenit 8, të ligjit nr. 8098, datë 28.3.1996, "Për statusin e të verbrit", të ndryshuar, të neneve 1 dhe 5, të ligjit nr. 8153, datë 31.10.1996, "Për statusin e jetimit", të ndryshuar, të neneve 2 dhe 8, të ligjit nr. 8626, datë 22.6.2000, "Për statusin e invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik", të ndryshuar, të neneve 1 dhe 15, të ligjit nr. 7889, datë 14.12.1994, "Për statusin e invalidit", të ndryshuar, të nenit 5, të ligjit nr. 10289, datë 17.6.2010, "Për mënyrën e trajtimit ekonomik e financiar dhe për dhënie ndihme të menjëhershme familjeve të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit, të Forcave të Armatosura, të Shërbimit Informativ të Shtetit dhe të Policisë së Burgjeve, që humbin jetën në krye apo për shkak të detyrës", të ligjit nr. 7748, datë 29.7.1993, "Për statusin e ish-të dënuarve dhe të përndjekurve politikë nga sistemi komunist", të ndryshuar, dhe të neneve 5 dhe 7, të ligjit nr. 9355, datë 10.3.2005, "Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore", të ndryshuar, VKM nr.698, datë 21.11.2018 Për një shtesë në Vendimin nr. 269, datë 29.3.2017 të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e kategorive të individëve që plotësojnë kriteret e pranimit në një program të ciklit të parë të studimeve profesionale që përjashtohen nga tarifa vjetore e shkollimit", VKM nr.779, datë 26.12.2018 " Për disa ndryshime në Vendimin nr. 269, datë 29.3.2017 të Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e kategorive të individëve që plotësojnë kriteret e pranimit në një program të ciklit të parë të studimeve, në një program të integruar të studimeve në një program të studimeve profesionale, që përjashtohen nga tarifa vjetore e shkollimit" të ndryshuar, shkresave të Fakulteteve, Bordi i Administrimit, në mbledhjen e datës 23.01.2020,

**VENDOSI:**

1. Përjashtimin në masën 100%, nga tarifa vjetore e shkollimit, studentët të cilët vijojnë studimet në ciklit e parë me kohë të plotë pranë Universitetit "Aleksandër Moisiu", Durrës, të cilët vijnë nga shtresa sociale si kategori në nevojë, 41 studentë, efekti financiar 1025000 lekë, sipas tabelës bashkëlidhur.

2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet:

- Administratori
- Drejtoria e Administrimit Financiar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**Kryetar i Bordit të Administrimit**  
**Ilirjana NANO**



MIRATUAR 23.01.2020

TABELA PERMBLEDHËSE MBI NUMRIN E STUDENTEVE TE CIKLIT TE PARE TE CILET  
PERJASHTOHEN NGA TARIFA DHE EFEKTI FINANCIAR  
PER VITIN AKADEMIK 2019-2020

Shkresa referuese	Fakulteti	Nr i studenteve te perjashtuar ne maen 100% nga tarifa e shkolimit	Efekti financiar per vitin akademik 2019-2020 ( ne leke)	Studente qe vijne nga familje qe trajtohen me ndihme ekonomike	Studente qe jane vete me aftesi te kufizuara	Studentët, të cilët i kanë prindërit me aftesi të kufizuara, të vërtetuara me vendim të Komisionit Mjekësor të Caktimit të Aftësisë për Punë,	Studentët, të cilët i kanë të dy prindërit pensionist ose njerin prind pensionist dhe tjetri nuk jeton	Studentët romë dhe ballkano - egjiptianët, të konfirmuar si të tillë nga vetdeklarimi	Studentët familje te ish te perndjekurve politike nga sistemi komunist ose familje me prinder te denuar me heqje lirie	Studentët, të cilët kanë prindërit dhe janë të dy student
Shkresa nr. 14 date 10.01.2020 e F akultetit te Biznesit	FB	7	175,000	3	1	1	2			
Shkresa nr. 14/1 date 13.01.2020 e F akultetit te Shk. Pol -	FSHPJ	4	100,000	4						
Shkresa nr. 14 date 08.01.2020 e F akultetit te Edukimit	FE	2	50,000	1					1	
Shkresa nr. 24 date 17.01.2020 e F akultetit te Studimeve	FSP	28	700,000	20	2		2	3		1
		0								
<b>TOTALI</b>		<b>41</b>	<b>1,025,000</b>	<b>28</b>	<b>3</b>	<b>1</b>	<b>3</b>	<b>3</b>	<b>1</b>	<b>1</b>

